



Nr./Br. 2541-2017

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 11.12.2017, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Z. ALBAN FAZLIU** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Mitrovicë e Jugut nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës - PDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **z.Avni Kastrati**
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së , që ky vendim t'i komunikohet **z.Alban Fazliu**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ, më datën 11.12.2017, nr.2524/2017, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit z.Avni Kastrati, pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye personale.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është z.Alban Fazliu, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 11.12.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

